REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 19.10.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 14.10.2026, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Eurofamis Sh.a"., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i shtratit të Lumit Gusha Batushë", Nr. i prokurimit- 632-26-8503-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-067-521, nxjerr:

V E N D I M

1. **REFUZOHET SI E PABAZUAR** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Eurofamis Sh.a"., e dt. 14.10.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i shtratit të Lumit Gusha Batushë", Nr. i prokurimit- 632-26-8503-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-067-521, kundër dosjes së tenderit dhe njoftimi për kontratë, të publikuara më datë, të datës 12.10.2026 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **VËRTETOHET** dosja e tenderit dhe njoftimi për kontratë, të publikuara më datë 12.10.2026;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

A r s y e t i m

Operatori ekonomik "Eurofamis Sh.a"., me dt.14.10.2026, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i shtratit të Lumit Gusha Batushë", Nr. i prokurimit- 632-26-8503-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-067-521.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Gjakovës, më datë 19.10.2026, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe, pas analizimit dhe vlerësimit të pretendimeve të parashtruara, ka konstatuar se:

Prentendimi i Operatorit Ekonomik lidhur me kërkesën për ndryshimin e kërkesave të Aneksit 7 dhe lejimin e pajisjeve ekuivalente

Autoriteti Kontraktues gjatë përgatitjes dhe zhvillimit të aktivitetit të prokurimit, ka përcaktuar kërkesat për mjetet e përcaktuara në Aneksin 7 të cilat të janë të domosdoshëm për shkak të kushteve konkrete të qasjes në terrenin e Lumit Gusha dhe me nevojat për realizimin e punimeve, të cilat nuk përbëjnë kufizim të pajustifikuar të konkurrencës.

Kërkesat e përcaktuara në Aneksin 7 janë hartuar duke marrë parasysh natyrën, kompleksitetin, vëllimin dhe kushtet e realizimit të punimeve dhe kanë për qëllim sigurimin e kapaciteteve të nevojshme teknike për realizimin e kontratës.

Fakti që Operatori Ekonomik propozon përdorimin e pajisjeve ose kombinimeve të tjera nuk dëshmon se kërkesat e Autoritetit Kontraktues janë të panevojshme, diskriminuese apo joproporcionale.

Autoriteti Kontraktues nuk ka përcaktuar kërkesa me qëllim të favorizimit të një operatori ekonomik të caktuar, por për të siguruar që operatori i cili do ta realizojë kontratën të disponojë kapacitetet dhe pajisjet e nevojshme për kryerjen e punimeve sipas kërkesave të projektit.

Për këtë arsye, kërkesa e përgjithshme për heqjen e kufizimeve dhe pranimin e çdo pajisjeje tjetër të mundshme nuk mund të aprovohet pa dëshmi konkrete se pajisja alternative është funksionalisht, teknikisht dhe në aspektin e sigurisë ekuivalente me pajisjen e kërkuar.

Gjithashtu, kërkesat e përcaktuara në Aneksin 7, pika 2 dhe pika 3, për kapacitetin maksimal bartës prej 830 kg dhe 2.5 ton, përkatësisht për konfigurimin e kamionit dubellkabin kiper me kran, janë kërkesa teknike të përcaktuara në funksion të nevojave operative dhe mënyrës së realizimit të punëve objekt të kontratës. Fakti se mund të ekzistojnë mjete me kapacitet më të madh bartës nuk dëshmon se ato janë automatikisht ekuivalente me mjetet e kërkuara, pasi ekuivalenca duhet të vlerësohet në tërësi, duke marrë parasysh konfigurimin, dimensionet, manovrueshmërinë, funksionalitetin dhe përshtatshmërinë e mjetit për realizimin e punëve. OE nuk ka ofruar argumente apo dëshmi konkrete që do të provonin se këto kërkesa janë të panevojshme, të pamundura për t'u përmbushur apo të palidhura me objektin e kontratës. Për këtë arsye, nuk ekziston bazë për heqjen apo ndryshimin e kërkesave teknike të përcaktuara në Aneksin 7.

Prentendimi i Operatorit Ekonomik lidhur me pikën 8 – Gjysmërimorkio kiper me kran, minimum 6 m dhe maksimum 1.2 t

Autoriteti Kontraktues qëndron pranë kërkesës së përcaktuar në pikën 8 të Aneksit 7.

Siç është sqaruar në përgjigjen ndaj pretendimit përkatës, kërkesa për gjysmërimorkio kiper me kran është përcaktuar për të mundësuar realizimin e integruar të funksioneve të transportit, shkarkimit dhe manipulimit të materialeve.

Kërkesa për gjatësinë minimale dhe kufirin e peshës është pjesë e konfigurimit teknik të mjetit të konsideruar të përshtatshëm për kushtet e punimeve. Operatori Ekonomik nuk ka dëshmuar se këto parametra janë vendosur për të favorizuar një operator të caktuar ose se ekziston një pajisje konkrete alternative që do të garantonte të njëjtin funksionalitet dhe siguri.

Prentendimi i Operatorit Ekonomik lidhur me pikën 13 – Sharrë prerëse hidraulike maksimum 50 kg

Autoriteti Kontraktues qëndron pranë kërkesës për sharrë prerëse hidraulike që montohet në krahun e ekskavatorit.

Kjo pajisje është paraparë në funksion të punëve të pastrimit të terrenit. Montimi në krahun e ekskavatorit mundëson operim të kontrolluar dhe qasje në zona ku realizohen punimet.

Kufiri maksimal prej 50 kg është përcaktuar duke pasur parasysh përputhshmërinë dhe sigurinë e pajisjes me makinerinë bartëse, pasi pesha e pajisjes ndikon në stabilitetin, manovrueshmërinë dhe ngarkesën e ushtruar mbi krahun e ekskavatorit.

Rrjedhimisht, kërkesa për heqjen e kufirit prej 50 kg dhe lejimin e konfigurimeve të tjera refuzohet.

Për pikën 7 – Nivelizuesi digjital-Edhe pretendimi lidhur me nivelizuesin digjital nuk është i bazuar. Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar këtë pajisje në funksion të nevojave teknike të punimeve të parapara në kontratë, veçanërisht për punët që kërkojnë kontroll të niveleve, kuotave dhe saktësisë së punimeve.

Fakti që OE pretendon se dokumentet nuk përcaktojnë një tolerancë të saktë të nivelimit nuk e bën kërkesën për nivelizues digjital të panevojshme. Përkundrazi, kërkesa për një pajisje të tillë mund të jetë pjesë e mënyrës së organizimit dhe kontrollit të punimeve nga Autoriteti Kontraktues.

Po ashtu, pretendimi për lejimin e "pajisjeve ekuivalente" është i pabazuar nëse dokumentet e tenderit nuk kanë përcaktuar markë, prodhues apo model specifik, por vetëm një karakteristikë funksionale të pajisjes. Në këtë rast, operatorët ekonomikë nuk janë të kufizuar në një produkt të caktuar.

Për pikën 9 – Dy gjysmë-rrotullues sinjalizues LED-Edhe kjo kërkesë nuk përbën kufizim të konkurrencës. Dy gjysmë-rrotulluesit sinjalizues LED janë kërkuar për rritjen e dukshmërisë dhe sigurisë gjatë operimit të makinerive në terren, veçanërisht gjatë punëve ku makineritë mund të jenë në lëvizje ose të operojnë në zona ku kërkohet paralajmërim vizual për pjesëmarrësit e tjerë.

Nëse pajisja kërkohet për qëllime të sigurisë në punë dhe sinjalizimit të makinerive, kjo kërkesë është drejtpërdrejt e lidhur me ekzekutimin e kontratës dhe nuk mund të konsiderohet si kërkesë e panevojshme vetëm për faktin se OE nuk e konsideron të domosdoshme.

Prentendimi i Operatorit Ekonomik lidhur me pikën 11 – Ekskavatori maksimum 13 t

Autoriteti Kontraktues qëndron pranë kërkesës për ekskavator me peshë maksimum 13 t.

Kjo kërkesë duhet të vlerësohet në raport me tërësinë e pajisjeve të kërkuara në Aneksin 7. Fakti që kërkohet edhe një ekskavator mbi 20 t dhe një ekskavator deri 8 t nuk e bën të panevojshëm ekskavatorin e kategorisë deri 13 t, pasi këto pajisje kanë karakteristika dhe kapacitete të ndryshme operative.

Qëllimi i kërkesës është që kontraktuesi të ketë në dispozicion një makineri të ndërmjetme, e përshtatshme për punime ku kërkohet kombinimi i kapacitetit të nevojshëm të gërmimit me manovrueshmërinë dhe përshtatshmërinë e një makinerie më të lehtë.

Sa i përket librezës dhe regjistrimit, dëshmitë për pronësinë, posedimin ose të drejtën e shfrytëzimit të pajisjes do të vlerësohen në harmoni me kërkesat e FDT-së.

Kështu që, pas shqyrtimit të kërkesave të Operatorit Ekonomik, Autoriteti Kontraktues konstaton se pretendimet e ngritura nuk kanë dëshmuar se kërkesat teknike të Aneksit 7 janë të panevojshme, diskriminuese ose të vendosura me qëllim të kufizimit të konkurrencës.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Kopje:
Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Të gjitha palëve te interesuara;

FATON GUTAJ

_____

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Këshilla juridike:
Kundër këtij vendimi, pala e paknaqur brenda afatit prej 10 ditëve mund të paraqesë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).